



BASHKIA KAMEZ  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PROJEKTEVE, INVESTIMEVE

## RELACION TEKNIK

### **PER PROJEKTIN E ZBATIMIT**

**Ndërtim Rruga "Haki Stermilli", Rr. "Dine Doda"  
Rr. "Akademie", Rr. "Ujemisht"**

**Lagje Bathore, Bashkia Kamez.**

Punuan:

Ing. Erblin Lala

Ing. Emanuela Meziu

Drejtore e Projekteve dhe Investimeve

Ing. Flora Muça

Drejtor i Pergjithshem

Elvis GJIKA

MIRATOI

Rakip SULI

KRYETAR



# PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

## 1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1- Hyrje
- 1.2- Pozicioni i objektit
- 1.3- Gjendja Ekzistuese
- 1.4- Kushtet Klimatike te Zones
- 1.5- Rilevimi Topografik
- 1.6- Studimi Gjeologjik

## 2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

- 2.1- Projekti i rruges

## 3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

- 1. Preventivi i punimeve te ndertimit te rruges.

## 1. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT

### 1) TE PERGJITHSHME

#### 1.1-Hyrje

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion do te realizoje projektin e zbatimit per rrugen:

Ndertim rruget “Haki Stermilli” 2 segmente, Rr.“Ujemisht”, Rr.“Akademie”, Rr. “Dine Doda” lagje Bathore Bashkia Kamez.

## **1.2-Pozicioni i objektit**

Kto rruge lidhin segmentet rrugore ne lagjen Bathore 7 ne Njesine Bathore, Bashkia Kamez

Segmentet rrugore ku do te investohet ka gjatesite perkatesisht”

- Rruga “Haki Stermilli” L = 385 ml.
- Rruga “Haki Stermilli” L = 215 ml.
- Rruga “Ujemisht” L = 220 ml.
- Rruga “Akademja” L = 215 ml.
- Rruga “Dine Doda” L = 230 ml.

## **1.3-Gjendja ekzistuese**

Gjendja aktuale e objektit paraqiten:

### **Trupi i rruges:**

Ne keto segmente rrugore do te investohet per ndertim asfalti, totuari, kub, dhe ndricim ato ndodhet ne brendesi te lagjes Bathore 7 ne zonen Kamez.

**Sistemi i K.U.N :** Kjo zone ka rrjet ekzistues K.U.N-je.

**Sistemi i K.U.B :** Nuk ka rrjet ekzistues K.U.B-je.

**Sistemi i UJESJELLESIT:** Ne kete zone ka linje ujesjellesi.

**Ndriçimi rrugor :** Mungon.

**Sistemi elektrik :** Sistemi i elektricitetit eshte ajeror ne njerен ane te rruges.

## **1.4-Kushtet Klimatike te Zones**

Zona dallohet per dimer te bute me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme .

Si gjithe zona mesdhetare, ne per gjithese ka nje sasi te konsiderueshme kohe me diell. Kjo arrin ne 2560 ore ne vit, me maksimum ne muajin Korrik me 360 ore dhe minimum 100 ore ne Dhjetor .

Presioni atmosferik sipas te dhenave shume vjeçare leviz nga 752-753 milimetra, e barabarte kjo me 1002.6-100.9 milibar.

Vlerat e temperatures se ajrit ne per gjithesi jane te qendrueshme .

Periudha me temperaturat mesatare  $> 7^{\circ}\text{C}$  zgjat afersisht 10 muaj.

Kjo zone perfshihet ne zonen klimaterike mesdhetare fushore qendrore.

Temperatura mesatare vjetore leviz ne  $15\text{--}16^{\circ}\text{C}$ . Temperatura maksimale eshte regjistruar ne date 13.07.1973 me  $43^{\circ}\text{C}$ , ndersa temperatura minimale eshte regjistruar ne date 15.01.1968 me  $-14.4^{\circ}\text{C}$ .

Amplituda e ndryshimeve midis dites dhe nates eshte e ndjeshme dhe leviz nga 6 deri ne  $12\text{--}14^{\circ}\text{C}$ .

Lageshtia mesatare relative e ajrit arrin ne rreth 70 %.

Sipas te dhene shumvjeçare statistikore te sherbimit hidrometeorologjike, sasia mesatare vjetore e shiut arrin ne 1247 mm numri i diteve me reshje eshte  $> 10 \text{ mm}$  leviz mesatarisht nga 85 ne 100 dite.

Era fyrn per gjithesisht ne dy drejtime. Gjate gjysmes se ftohte te vitit mbizoteron juglindja pa perjashtuar veriun, ne gjysmen e ngrohte te vitit mbizoteron veriperendimi.

## 1.5-Rilevimi Topografik

Per hartimin e Relievit te zones gjate muajit gusht jane kryer matjet topografike ne terren. Ne baze te ketyre matjeve eshte hartuar planimetria e gjendjes ekzistuese ne shkallen 1:500 dhe profilet gjatesore, qe do te jene baze per zgjidhjen e projektit.

## 1.6-Studimi Gjeologjik

Nga ana e ndertimit gjeologjik, rajoni i Tiranes ben pjesa ne strukturen e sinklinalit te Tiranes, e cila ndertohet kryesisht nga formacione e moshes se Neogenit ( N 2 ) - Keto formacione ndertojne vargjet kodrinore qe qarkojne qytetin dhe perfaqeson nga pako ranore, alevrolite dhe argjila alevrolitike. Gjithashtu keto formacione sherbejne si bazament i depozitimit me te reja kuaternare ( Qu ). Depozitimet kuaternare ndertojne gjithe pjesen fushore ku eshte ndertuar qyteti i Kamzes dhe pjesa tjeter e zones ne studim. Keto depozitime perfaqesohen nga dhera suargjilore, suranore, si dhe depozitime aluvionale zhavorore te lumenjve te Tiranes, te Lanes dhe te teracave te tyre, trashesia e per gjitheshme e te cilave arrin 3-4 m ekstremet e fushes deri ne rreth 20m ne pjeset e tjera te qytetit.

Zona qe trajtohet ne kete projekt, ben pjesa ne zonen e perhapjes se depozitimeve te terraces se dyte te lumi te Tiranes, e cila ze pjesen me te madhe dhe kryesore te teritorit te qytetit.

Depozitimet e kesaj tarace ku ben pjesa dhe zona ne studim, karakterizohen nga prania e dherave deluviale te perbera nga suargjila me ngjyre te kuqerremte dhe kafe te hapur, si dhe nga prania e depozitimeve zhavorore.

Keshtu ne zonen tone, ne pjesen me te siperme kemi te bejme me suargjila ngjyre kafe te kuqerremet, te pluhuruara, me lageshti, ne gjendje plastike dhe mesatarisht te ngjeshura . Trashesia e kesaj shtrese leviz 1,5- 3,5 m dhe karakterizohet nga keto tregues fiziko – mekanike mesatare:

- Pesha volumore ne gjendje natyrale .....  $\Delta = 1.25 - 1.76 \text{ g/cm}^3$
- Pesha volumore te skeletit .....  $\delta = 1.18 - 1.4 \text{ g/cm}^3$
- Koeficienti i porozitetit .....  $\varepsilon = 0.85 - 1.2$
- Kendi i ferkimit te brendshem .....  $\phi = 17^\circ - 22^\circ$
- Kohezioni .....  $c = 0.25 - 0.50 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar ne shtypje .....  $\delta = 1.2 - 1.7 \text{ kg/cm}^2$

Nen keto depozitime per gjithesisht takohen shtresa suargjilash te lehta dhe te mesme te pluhuruara , me ngjyre kafe te hapura ne gjendje plastike dhe mesatarisht te ngjeshura dhe kane trashesi qe arrin 2-4 m .

Keto depozitime ne ekstremi perendimor te zones dalin ne siperfaqe ketu fillon ndikimi i depozitimeve te terraces se lumi te Tirane dhe shtresa e suargjilave te kuqeremta gradualisht reduktohet.

Keto depozitime karakterizohen nga keto tregues fiziko-mekanike:

- Pesha volumore ne gjendje natyrale .....  $\Delta = 1.82 - 2.0 \text{ g/cm}^3$
- Pesha volumore te skeletit .....  $\delta = 1.48 - 1.64 \text{ g/cm}^3$
- Koeficienti i porozitetit .....  $\varepsilon = 0.65 - 0.82$
- Kendi i ferkimit te brendshem .....  $\phi = 19^\circ - 24^\circ$
- Kohezioni .....  $c = 0.20 - 0.45 \text{ kg/cm}^2$
- Ngarkesa e lejuar ne shtypje .....  $\delta = 1.8 - 2.2 \text{ kg/cm}^2$

Pergjithesisht, nen depozitimet e pershkruara me siper, takohen depozitimet zhavorore, me perberje kryesisht ranore dhe gelqerore me madhesi nga 1-2cm deri 8-10cm, me rrumbullakosje mesatare dhe me mbushes materiali suranor dhe suargjilor te lehte; te cilat karakterizohen nga tregues te mire fiziko-mekanike.

Trashesia e ketyre depozitimeve leviz nga 1-3 m dhe per gjithesisht paraqiten ujembajtes. Se fundi, nen depozitimet kuaternare te larte permendura, ne taban te tyre kemi te bejme me formacionet renjesore te cilat perbehjen kryesisht nga

argjila alevrolite ngjyre gri kalter ne gjendje kompakte, dhe ne disa raste nga ranore kokerr imet me cimentim te dobet me ngjyre gri e te verdhe.

## 1. **ZGJIDHJA E PROJEKTIT**

### 1.1- Projekti i asfaltimit te segmentit rrugor

Segmenti rrugor parashikohet te jete me akse me dy pjerresi, me asfalt.

- **Gjatesia e Rruges “Haki Stermilli” L = 385 ml.**  
**Gjeresia B = 7 m**  
**Gjeresi asfaltit b = 4.2m, 2 x 0.4 m kunete, 1x1 trotuar**
- **Gjatesia e Rruges pingul me “Haki Stermillin” L = 215 ml.**  
**Gjeresia B = 6 m**  
**Gjeresi asfaltit b = 5m, 2 x 0.5 m kunete**
- **Gjatesia e Rruges “Ujemisht” L = 220 ml.**  
**Gjeresia B = 6 m**  
**Gjeresi asfaltit b = 5m, 2 x 0.5 m kunete**
- **Gjatesia e Rruges “Akademia” L = 215 ml.**  
**Gjeresia B = 6 m**  
**Gjeresi asfaltit b = 5 m, 2 x 0.5 m kunete**
- **Gjatesia e Seg te Rruges “Kongresi i Lushnjes” L = 320 ml.**  
**Gjeresia B = 4 m**
- **Gjatesia e Rruges “Dine Doda” L = 230 ml.**  
**Gjeresia B = 5 m**  
**Gjeresi asfaltit b = 4 m, 2 x 0.5 m bankine**

Ne zgjidhjen e projektit jane pasur parasysh:

- a) Zgjidhja ne anen Planimetrike te rruges.
- b) Zgjidhja ne anen altimetrike te rruges.
- c) Elementet sociale te rruges.

### ***1. Zgjidhja Planimetrike***

Ne zgjidhjen planimetrike eshte pasur parasysh ndertimi i rruges te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese.

Ne hyrjet e banesave do te behet rakordimi i tille qe lejon hyrjen normale te mjeteve.

### ***2. Zgjidhja Altimetrike.***

Nga ana altimetrike reliivi faktik ne drejtimin gjatesor ka nje pjerresi te lehte ne renie drejt lindje - perendimit. Meqe objektet do te ndertohet mbi rruge ekzistuese te cilat kane nivelete te çrregullta do te synohet ne krijimin e dy niveletave me pjerresi te lehte e uniforme.

### ***3. Profili Gjatesor.***

Profili gjatesor perfaqeson prerjen e rruges sipas aksit te saj ne drejtimin vertikal. Profili gjatesor eshte hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe ne shkalle horizontale 1:1000.

Ne te jane paraqitur:

- Vija e Terrenit
- Vija e Projektit
- Disnivelet e Viges se Projektit
- Numri i Piketes (Sekcionit)
- Kuota e Terrenit
- Kuota e Projektit
- Distancat Pjesore
- Distancat Progresive

#### **4. Profilat Terthore.**

Profilat terthore perfaqesojne prerje te rruges terthor me aksin e saj ne drejtimin vertikal.

Profilat terthore jane hartuar ne shkalle vertikale dhe horizontale 1:100.

Ne profilat terthore jane paraqitur:

- Numri i profilit
- Distanca progresive
- Vija e terrenit
- Vija e projektit
- Disnivelet e vijes se projektit
- Numri i piketes
- Kuotat e terrenit
- Kuotat e projektit
- Distancat pjesore nga aksi
- Distancat e pergjithshme nga aksi

#### **5. Profilat Terthore.**

Ne profilat tip jane paraqitur ne menyre te detajuar:

- Shtresat rrugore
- Dimensionet e tyre
- Vendosja e tyre
- Distancat
- Zona ku aplikohet profili tip

#### **6. Zgjidhja sociale.**

Duke pasur parasysh qe kjo zone eshte ne zhvillim e siper eshte pasur parasysh qe kjo rruga te behet me parametra qe t'i pershtaten zhvillimit te zones dhe hyrje daljet nga shtepite te kene lirshmeri. Keto segmente rrugore lidhin lagjet Bathore 7 ne zonen Kamez.

#### **7. Llogaritja e shtresave te rruges.**

Nga studimi i gjendjes ekzistuese del qe asfaltimi do te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese.

## **8. Shtresat e rruges.**

Per te gjithe segmentin rrugor shtresat e dala nga llogaritja do te jene:

Asfaltobeton	4 cm
Binder	6 cm
Stabilizant	10 cm
Çakull	20 cm

## **9. Vijezimet e Rruges**

Per gjithe gjatesise se segmentin rrugor eshte parashikuar vijezimi i rruges.

Në përgjithësi në kryqëzim është e përcaktuar për kalimin e këmbësorëve. Vijezimi i ruges do te jete një vijë e bardhë e fortë dhe një vije e kuqe në sipërfaqen e rrugës që shtrihet në të gjithë korsinë, e cila përdoret së bashku me një shenjë ndalimi ose kërkesa të tjera ligjore që tregojnë pikën pas së cilës automjetet duhet të ndalojnë.

Janë shenja tërthore të sipërfaqes së rrugës që informojnë drejtuesit e mjeteve se ku duhet të ndalojnë dhe drejton këmbësorin për të kaluar nga një rrugë në tjetrën.

Vijat e vendkalimit duhet të janë vija të bardha të forta dhe vija te kuqe.


Gjerësia e tyre nuk duhet të jetë më e vogël se 150 mm dhe nuk duhet të janë të vendosura më pak se 600 mm larg.

## **10. Rampat**

Rampat duhet të vendosen kudo ku ka një rrugë të aksesueshme e cila ka një bordurë më lartësi më të madhe se 30 mm. Kur trotuari bashkohet me nivelin rrugor ose ndërpritet nga një zonë e rezervuar, lejohen platforma të shkurtra jo më të madhe se 15% për një disniveli maksimal prej 150 mm. Ne rastet kur ishulli i këmbësorëve ndodhet në nivel me rrugën atëherë 150 mm nga fillimi dhe 150 mm nga fundi shënohet vija relivore paralajmëruese me gravure në drejtim të lëvizjes, në gjerësi jo më të vogël se 400 mm.

### **a. Pjerrësia**

Pjerrësia maksimale për ndërtimin e ri duhet të jetë 1:12. Pjerrësia maksimale e ulluqeve



(sipërfaqja e rrugës) ngjitur me platformën kufitare ose rrugën e aksesueshme nuk duhet të kalojë 1:20. Disniveli optimal mes rrafshit rrugor dhe rrafshit të terrenit duhet të jetë 0.00 mm

**b. Gjerësia**

Gjerësia minimale e një rampe duhet të jetë 120 mm, duke përjashtuar anët .

**2. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT**

PROJEKT – ZBATIM PERMBAN KETO KAPITUJ:

1. KAPAKU I PROJEKTIT
2. IMAZHI AJROR
3. PLANIMETRIA EKZISTUESE
4. PLANIMETRIA E ASFALTIT
5. PLANIMETRI NDRICIMI
6. PLANIMETRI KUB
7. PROFILI TERTHORE TIP